



Rishikimi i projeksiioneve makroekonomike - maj 2024 -



dr. Anita Angellovska-Bezhoska,
guvernatorja



Efektet e goditjeve globale u ndjenë edhe vitin e kaluar

Edhe pse lëvizjet globale udhëzojnë për stabilizim dhe rezistencë të moderuar në vitin 2023, pasojat e goditjeve ishin të dukshme në disa segmente:

- **Rritjen ekonomike globale**, megjithëse ishte pak më mirë se parashikimet, edhe më tej vazhdon të ngadalësohet në **3,2%**, që është nën normat historike të periudhës para pandemisë;
- **Inflacionin global**, pas niveleve më të larta historike në vitin 2022, u ngadalësua ndjeshëm vitin e kaluar në mesatarisht **6,8%** (në ekonomitë më pak të zhvilluara në 8,3%), por është ende mbi mesataren historike për shumicën e ekonomive;
- **Rreziqet për stabilitetin financiar janë rritur**, gjë që u reflektua në falimentimin e disa bankave në ShBA, por si rezultat i reagimit të shpejtë të rregullatorit, nuk rezultoi në efekte të rëndësishme të përhapjes në shkallë më të gjerë, duke përfshirë Europën;
- **Rreziqet nga tensionet gjeopolitike dhe reduktimi i flukseve tregtare dhe financiare janë rritur**, e cila është e dukshme përmes numrit gjithmonë e në rritje të barrierave tregtare - 3000 barrieratë reja, që është tre herë më shumë krahasuar me vitin 2019.





Sipas parashikimeve të FMN-së pasojat do të ndjehen edhe në periudhë afatmesme


- **Rritja globale gjatë dy viteve të ardhshme, vlerësohet në 3,2% (njëjtë si vitin e kaluar),** me përshejtim të lehtë në ekonomitë e zhvilluara dhe ngadalësim të lehtë në ato më pak të zhvilluara. Në krahasim me parashikimet e tetorit, ky është rishikim i vogël në rritje për vitin 2024 (0.3 p.p.).
- **Rritja e parashikuar që do të vazhdojë të jetë më e dobët në krahasim me mesataren historike** në dekadën para pandemisë (3,8%).
- **Pritet që inflacioni global të vazhdojë të ngadalësohet** në 5,9% në vitin 2024 dhe 4,5% në vitin 2025, ngjashëm si në muajin tetor, me vlerësimet për kthimin e tij në mesataren para pandemisë vitin e ardhshëm në vendet e zhvilluara, ndërsa një vit më vonë në ekonomitë më pak të zhvilluara.
- **Rreziqet e rritjes ekonomike globale dhe inflacionit vlerësohen të balancuara.**

Rreziqet negative të rritjes:

- Goditje e mundshme e re e çmimeve në kushtet kur ka ende tensione gjeopolitike;
- Ngadalësim më i dobët i inflacionit bazë dhe mbajtje më e gjatë e kushteve të shtrënguara financiare;
- Rritje më e dobët e ekonomisë kineze, e dyta më e madhe në botë;
- Konsolidim më i fuqishëm fiskal;
- Më shumë kufizime tregtare dhe fragmentim më i fortë gjeo-ekonomik.

Rreziqet pozitive të rritjes:

- Konsolidim më i ngadaltë fiskal;
- Ngadalësim më i fuqishëm i inflacionit bazë dhe lehtësim më i shpejtë i politikave monetare;
- Rritje e produktivitetit me zbatimin e inteligjencës artificiale.





Çfarë do të thotë ky mjedis global për kërkesën e eksportit të produkteve dhe shërbimeve tona?



- **Edhe më tej pritët rikuperimi i kërkesës së huaj**, me vlerësime të rritjes prej 0,8% në vitin 2024 dhe 1,6% në vitin 2025, por pak më i dobët se parashikimet e tetorit (1% në vitin 2024 dhe 1,7% në vitin 2025).
- Rishikimi në rënie është kryesisht për shkak të arritjeve më të dobëta në BE, dhe veçanërisht në **ekonominë gjermane**.





Çfarë do të thotë ky mjedis global për çmimet e importit dhe eksportit tonë?

- Pas rritjes së lartë në vitet 2021 - 2022, vitin e kaluar u realizua rënie e theksuar e çmimeve të prodhimeve primare, ndërsa **pjesëmarrësit e tregut dhe INF-të parashikojnë rënie të mëtejshme të çmimeve këtë vit dhe stabilizimin e tyre në vitin 2025.**
- Në krahasim me parashikimet e tetorit:
 - **Për sa i përket energjisë dhe ushqimit** pritet rënie më e fortë e çmimeve dhe nivele më të ulëta të çmimeve këtë vit;
 - **Inflacioni i importuar është rishikuar lehtë në rritje për këtë vit, dhe për vitin e ardhshëm mbetet i pandryshuar,** ndërsa edhe më tej pritet ngadalësim, më saktësisht 3,5% (3,3% në tetor) këtë vit dhe 2,5% vitin e ardhshëm;
 - Te metalet pritet rënie kryesisht më e fortë për vitin 2024, ndërsa lëvizje pak më të mira vitin e ardhshëm;
 - ***Në përgjithësi, në krahasim me parashikimet e tetorit, kjo tregon për kushte mesatarisht më të favorshme për shkëmbim (ushqim dhe energji), ndërkaq, pasiguria ekziston akoma.***





Supozime kryesore për parashikimet e ekonomisë maqedonase

- **Ekonomia globale dhe kërkesa e huaj** edhe më tej do të rikuperohen, megjithatë konteksti i jashtëm është ende i pasigurt, me rreziqe për rritjen ekonomike dhe inflacionin.
- **Çmimet botërore** do të ulen edhe këtë vit, pas së cilës pritet stabilizimi i tyre vitin e ardhshëm.
- Duke pasur parasysh ngadalësimin e inflacionit, **këtë vit do të fillohet me lehtësimin monetar nga ana e bankave qendrore në ekonomitë e zhvilluara**, dhe rrjedhimisht lehtësimi i kushteve financiare globale.
- **Konsolidimi fiskal do të vazhdojë edhe në periudhën afatmesme**, duke u mbështetur në burimet e brendshme dhe të jashtme të financimit të deficitit buxhetor.
- **Investimet në infrastrukturën publike do të përshpejtohen**, sidomos nga gjysma e dytë e vitit 2024.
- **Flukse hyrëse solide të investimeve të huaja direkte.**
- **Rritje solide në të ardhurat e disponueshme**, e mbështetur nga rritja reale më e fuqishme e masës së pagave, në kushtet e shtrënguara të tregut të punës.




Projeksioni afatmesëm makroekonomik 2024 – 2026



Projeksioni i PBB-së


- Për këtë vit parashikojmë rritje ekonomike prej **2,6%**, ndërsa për vitin tjetër **3,6%**.
- Kjo do të thotë **korrigjim në rënie në raport me parashikimet e tetorit** që është reflektim i: rritjes më të dobët vitin e kaluar (rënie prej 16,7% e investimeve krahasuar me rritjen e parashikuar), performancës më të dobët në tremujorin e parë të këtij viti, rishikimit në rënie të rritjes të partnerët tanë më të rëndësishëm tregtarë dhe zbatimit më të ngadalshëm të projekteve të paralajmëruara të infrastrukturës publike.
- **Në afat të mesëm**, në pajtueshmëri me mjedisin e pritur më të favorshëm global (ritje më e lartë e kërkesës së huaj) dhe përshpejtimin e projekteve të infrastrukturës, pritët përshpejtim gradual i rritjes. Megjithatë, pasiguria dhe rreziqet globale ekzistojnë akoma.





Parashikimi i PBB-së për 2024–2025


- **Për sa i përket strukturës së rritjes**, në vitin 2024 dhe 2025, do të vijë nga kërkesa e brendshme, me kontribut negativ nga eksportet neto.
- **Konsumi privat** – rritje mesatare prej 3,3%, e mbështetur kryesisht nga rritja e të ardhurave të disponueshme dhe e kreditimit;
- **Investimet** – pas rënies së madhe, rritje mesatare prej 8,7%, mbështetur nga investimet publike dhe private, në kushte solide të investimeve të huaja direkte dhe rritjes së kredisë;
- **Aktiviteti i eksportit** - rritje mesatare solide prej 4,6%, në pajtim me rritjen e pritshme të tregtisë botërore, rimëkëmbjen e kërkesës së huaj dhe kontributin e mëtijshëm pozitiv të kompanive në industrinë e automobilave;
- **Importi** – me rritje të eksportit dhe kërkesës së brendshme, të cilat kanë komponent të lartë importi, parashikohet rritje e importit prej 5,1%.





Parashikimi i inflacionit

- **Në përgjithësi, pritet ngadalësim i mëtejshëm i inflacionit, i cili vitin e kaluar u ul në nivel njëshifror.**
- **Arritjet në tremujorin e parë të këtij viti** (normë mesatare vjetore prej 3,4%) janë më të ulëta se parashikimet e tetorit.
- **Inflacioni mesatar për vitin 2024 parashikohet të ngadalësohet duke u ulur në 3,5%** (nga 9,4% vitin e kaluar), duke reflektuar rënien e mëtejshme të çmimeve të naftës dhe ushqimeve në tregjet botërore, ngadalësimin e inflacionit të huaj efektiv, si dhe kushtet e shtrënguara financiare.
- **Në afat të mesëm,** pritet ngadalësim i mëtejshëm i inflacionit dhe ulje e tij në mesataren historike prej rreth 2%.
- **Parashikimi për vitin 2024 është në kufirin e poshtëm të intervalit të parashikuar nga muaji tetor (3,5 – 4%),** ndërsa vlerësimet për dy vitet e ardhshme janë të pandryshuara.
- **Megjithatë, rreziqet e inflacionit ekzistojnë ende** dhe lidhen kryesisht me çmimet e prodhimeve primare, ndryshimet në çmimet e rregulluara, si dhe politikat e kërkesës (të ardhurat e disponueshme) dhe marzhet e fitimit.





Krahasimi i parashikimeve të PBB-së dhe inflacionit në ekonominë tonë

Krahasim i parashikimeve për PBB-në dhe inflacionin për Maqedoninë e Veriut nga organizata të ndryshme

Organizata	Muaji i publikimit	Rritja reale e PBB-së, %		Inflacioni (norma mesatare, %)	
		2024	2025	2024	2025
FMN	prill 2024	2,7	3,7	4,0	2,5
Banka Botërore	prill 2024	2,5	2,9	3,0	2,0
Komisioni European	nëntor 2023	2,7	2,8	4,1	2,1
BERZH	shtator 2023	3,0	-	-	-
Consensus Forecast	prill 2024	2,9	3,6	3,9	2,8
Ministria e Financave	dhjetor 2023	3,4	4,8	3,6	2,0
Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut	prill 2024	2,6	3,6	3.5	2,0

Burimi: FMN-ja, Pasqyra ekonomike botërore, prill 2024; Banka Botërore, Raport i rregullt ekonomik për Ballkanin Perëndimor, pranverë 2024; Komisioni European, Parashikimet për ekonominë europiane, vjeshtë 2023; BERZH, Perspektivat ekonomike rajonale, shtator 2023; Consensus Forecast, prill 2024; Ministria e Financave, Strategjia Fiskale e Rishikuar 2024-2028, dhjetor 2023; dhe Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut, prill 2024.



Parashikimi i Bilancit të Pagesave - llogaria rrjedhëse-

Arritjet në vitin 2023 ishin dukshëm më të mira - suficiti i arritur në llogarinë rrjedhëse prej 0,7% të PBB-së (suficiti i dytë në historinë tonë).


Arritjet më të mira janë kryesisht rezultat i ngushtimit të deficitit tregtar:

- përmirësimi të **bilancit joenergjetik** (kërkesa dukshëm më e ulët për importe, pas rritjes së stoqeve të lëndëve të para në vitin e kaluar),
- përmirësimi edhe të **bilancit të energjisë** (për shkak të çmimeve më të ulëta botërore të energjisë dhe rritjes së prodhimit vendas të energjisë elektrike).

Për vitin 2024, pritet deficit i moderuar i llogarisë rrjedhëse prej 2,4% të PBB-së:

- **deficit tregtar më i lartë** - importi i lëndëve të para dhe materialeve do të normalizohet gradualisht, pas uljes së ndjeshme të tij në vitin e kaluar, në kushtet e deficitit të qëndrueshëm energjetik,
- stabilizimi i transfertave private dhe rrjedhimisht **suficit më i moderuar në të ardhurat sekondare**,
- lëvizje të mëtejshme pozitive në **bilancin e shërbimeve**.


Në periudhën afatmesme (2025 - 2026), parashikojmë deficit mesatar prej 2,1%, që do të thotë llogari rrjedhëse më e favorshme krahasuar me muajin tetor.





Parashikimi i Bilancit të Pagesave - llogaria financiare -

- **Pritet që hyrjet në llogarinë financiare të përbëjnë mesatarisht 3,5% e PBB-së (për periudhën 2024 - 2026), kryesisht në formën e investimeve të huaja direkte dhe huamarrjes së jashtme të shtetit.**
- Duke qenë se do të jenë më të larta se deficitin e llogarisë rrjedhëse (2,1% e PBB-së), do të mundësojnë **rritjen e mëtejshme të rezervave valutore.**
- Kështu, **treguesit e mjaftueshmërisë së rezervave valutore**, gjatë gjithë periudhës së parashikimit, do të qëndrojnë në zonën e sigurt.
- **Krahasuar me parashikimet e tetorit, niveli i rezervave valutore është më i lartë.**







Rritja e depozitave dhe kredive

- **Sistemi bankar vazhdon të ofrojë mbështetje solide kreditore** – për tremujorin e parë të vitit 2024, rritja e kreditimit ishte 6,1% me bazë vjetore (5,2% sipas parashikimeve të tetorit). Ndërkaq, **deri në fund të vitit 2024**, pritet që rritja e kredive të jetë e qëndrueshme dhe të arrijë në 6,1%.
- **Në periudhën afatmesme, 2025-2026, pritet rritje mesatare e kredive prej rreth 6,8%**, në kushtet e përshpejtimit gradual të rritjes ekonomike dhe stabilizimit të pritjeve, me rritje të moderuar të bazës së depozitave, si dhe me sistem bankar të qëndrueshëm dhe të shëndosh.
- **Depozitat, si burimi më i rëndësishëm i financimit, në tremujorin e parë të vitit 2024 shënuan rritje vjetore prej 9,6%** (9,1% sipas parashikimeve të tetorit), me kushte më të favorshme për kursime, rritje të të ardhurave të disponueshme të popullsisë, pritshmëri të qëndrueshme dhe forcimin të besimit, si dhe masat e ndërmarra nga Banka Popullore për nxitjen e mëtejshme të kursimeve.
- **Në fund të vitit 2024**, pritet rritje solide vjetore të depozitave nga **7,4%**, ndërsa **në afat të mesëm** për periudhën 2025-2026 mesatarisht rreth 7,6%.

Rritja e kredive



Rritja e depozitave





Përmbledhje

- **Krahasuar me parashikimet e tetorit, arritjet e deritanishme në të gjitha segmentet makroekonomike janë pak më të mira, përveçse në PBB-në.**
- **Sipas parashikimeve të fundit të FMN-së, në afat të mesëm, ekonomia globale do të vazhdojë të rritet, por me dinamika që janë nën mesataren e dy dekadave të fundit, ndërsa inflacioni global do të vazhdojë të ulet.**
- Me rritjen e ekonomisë globale, dhe veçanërisht me rritjen tek partnerët tanë tregtarë, pritet që **ekonomia maqedonase** të rritet me normë prej 2,6% këtë vit dhe 3,6% vitin e ardhshëm, dhe më pas rritja do të përshpejtohet në mënyrë të moderuar në periudhën afatmesme.
- Me stabilizimin e çmimeve botërore dhe politikës së kujdesshme monetare, pritet ngadalësim i mëtejshëm i **inflacionit**, ndërsa në afat të mesëm do të kthehej në mesataren historike prej 2%.
- Me flukse neto solide të parashikuara në llogarinë financiare që do të tejkalonin deficitin e llogarisë rrjedhëse, pritet rritje e mëtejshme e **rezervave valutore**, si garanci për stabilitetin e kursit të këmbimit.
- Megjithatë, **mjedisi global mbetet i pasigurt dhe i paparashikueshëm**, që krijon rreziqe për rritjen ekonomike, inflacionin dhe pozicionin e jashtëm, duke theksuar nevojën për politika të brendshme makroekonomike dhe strukturore të matura.
- **Banka Popullore ruajti karakterin prudent të politikës monetare, në pajtueshmëri me kushtet në ekonomi.** Norma e interesit për bonot e thesarit u mbajt në nivelin 6,30%. Gjithashtu, janë bërë ndryshime në përcaktimin dhe mënyrën e mbajtjes së rezervës së detyrueshme, të cilat kryesisht kanë për qëllim mbështetjen e mëtejshme të procesit të denarizimit dhe rritjen e kursimeve afatgjata në sistemin bankar, por gjithashtu ofrojnë mbështetje shtesë për politikën e kujdesshme monetare.
- Duke pasur parasysh strategjinë monetare të kursit të qëndrueshëm të këmbimit të denarit ndaj euros, ndryshimet në politikën monetare të brendshme reflektojnë edhe vendosjen e politikës monetare të Bankës Qendrore Europiane.
- ***Banka Popullore me kujdes, në baza ditore, i mbikëqyr të dhënat dhe rreziqet makroekonomike dhe, si deri më tani, do të marrë të gjitha masat e nevojshme, duke përdorur të gjitha instrumentet në dispozicion, me qëllim ruajtjen e stabilitetit të kursit të këmbimit dhe stabilizimin e inflacionit në afat të mesëm.***



*JU FALEMINDERIT PËR
VËMENDJEN!*